

AKTI I THEMELIMIT

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ABES” sh.p.k

Sot në datën 01.08.2022, unë Besnik Babasi, atësia Bajram, lindur më 27.03.1969, lindur në Tiranë, Shqipëri, banues në Tiranë, Rruga "Donika Kastrioti", Njësia Administrative Nr.5, Nd.1, Hyrja 5, Ap.23, Kodi postar 1019, vendosa të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar, "ABES" sh.p.k, mbështetur në nenin 2 paragrafi b, i ligjit “ Për sanksionet dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë të veprimtarisë private, të pavarur dhe të privatizimit”, në ligjin 9901, datë 14.04.2008 “ Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, në të cilën jam Ortak i vetëm dhe për këtë qëllim hartoj Aktin e Themelimit, me përmbajtjen si vijon:

Neni 1

EMRI

Shoqëria tregtare private me përgjegjësi të kufizuar, emërtohet "ABES" sh.p.k, e cila këtu e më poshtë do të quhet “Shoqëria”.

Neni 2

FORMA

2.1 Kjo Shoqëri është një **Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar**

Neni 3

BAZA JURIDIKE

3.1 Shoqëria krijohet në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ajo e fiton personalitetin juridik pas rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 4

SELIA

4.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në: Krujë, Halil,, Zona Kadastrale Nr.1921, Numri i Pasurisë 31/203-ND, Km. 2, Rruga Nacionale Fushë Krujë - Krujë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të ortakut.

Neni 5

TERRITORI

5.1 Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj si në territorin e Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe jashtë saj.

Shoqëria mund të krijojë degë (filiale) ose përfaqësi, si në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

Neni 6

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- Import-Eksport, tregtimin, prodhimin e përpunimin e lëndëve plasëse e shpërthyesë për përdorim civil, lëndëve piroteknike dhe fishekzjarre, depozitimin dhe shitjen e tyre.
- Import-Eksport, tranzit, transshipin, ndërmjetësimin, transferimin dhe ekspozimin e mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë.
- Import-Eksport, tranzit, transshipin, ndërmjetësimin, transferimin dhe ekspozimin e mallrave dhe teknologjive të mallrave ushtarake.
- Përdorimin e lëndëve plasëse e shpërthyesë të përdorimit civil.
- Përdorimin e lëndëve piroteknike dhe fishekzjarre.
- Transport i materialeve të ndryshme civile dhe i lëndëve plasëse të përdorimit civil dhe materialeve të rrezikshme, piroteknike dhe fishekzjarre.
- Shërbime transporti të materialeve të ndryshme civile, dhe i lëndëve plasëse të (rrezikshme), piroteknike dhe fishekzjarre, për të tretët dhe me qera.
- Shërbime magazinimi të lëndëve plasëse e shpërthyesë për përdorim civil, piroteknike dhe fishekzjarre për të tretët.
- Import-eksport, tregtim me shumicë e pakicë i materialeve të ndërtimit, ushqimore, blegtorale, industriale, konfeksione.
- Import-eksport, tregtimin me shumicë e pakicë të naftës, benzinës, gazit dhe vajrave lubrifikante.
- Prodhimin, tregtimin dhe transportimin e materialeve inerte, si: rëra, zhavorre, gurë, çakull, gëlqere, granile, dhe materialeve të ndryshme për ndërtim.
- Prodime të blloqeve të betonit dhe parafabrikateve të ndryshme.
- Ndërtime civile, industriale, turistike, monumentale e bujqësore. Rikonstruksione të këtyre lloj ndërtimesh.
- Ndërtim godina banimi shumëkatëshe, ndërtim vila, pallate.
- Ndërtime rrugësh dhe autostradë.

- Punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit në rrugë.
- Ndërtime hidraulike dhe hidroteknike, si: ujësjellës, kanalizime, kanale e impiante vaditje.
- Ndërtim tunelesh për rrugë automobilistike, hekurudhore dhe tunele hidroteknike për hidrocentrale.
- Ndërtime të veprave të veçanta, si punime nëntokësore, hidroizolime mbi dhe nëntokësore.
- Punime restaurimi të ndërtesave të ndryshme.
- Punime karpenterie, prej druri dhe metali.
- Punime druri dhe të nënprodukteve të tij.
- Punime shërbimi si: pastrim, mirëmbajtje dhe zhvillim i sipërfaqesh urbane.
- Parkim automjesh.
- Prodhimin dhe perpunimin e mermerit.
- Veprimtari në fushën e agro - turizmit, mbarështimin e florës dhe faunës, peshkimit si dhe administrimit të ujrave.
- Veprimtari në fushën e akuakulturës dhe rekreacionit.

Neni 7

KOHËZGJATJA

7.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakëve.

Neni 8

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi në para i Ortakut themelues të shoqërisë. Kontributi në para do të ketë një vlerë nominale të përgjithshme prej 100.000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në një kuotë të vetme e zotëruar nga Ortaku i vetëm i shoqërisë.

Ortaku i vetëm i shoqërisë tregtare “ABES” Sh.p.k zotëron kuotën në shoqëri si më poshtë:

- **Besnik Babasi, në cilësinë e Ortakut të vetëm themelues zotëron 100% të vlerës së kapitalit themeltar të barabartë me 1 (një) kuotë të vetme të përgjithshme prej 100.000 (njëqind mije) lekë.**

Ky kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortaku. Shoqëria mund të shtojë ose zvogëlojë kapitalin në varësi të nevojave dhe rezultateve të saj, sipas vendimit të ortakut.

Neni 9

KONTRIBUTET

9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga kontributet e Ortakut të vetëm.

Neni 10

PJESËT E KAPITALIT THEMELTAR

10.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 1(një) kuotë e vetme, plotësisht e shlyer.

Neni 11

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

11.1 Administrimi i Shoqërisë do të bëhet nga një Administrator. Administrator i shoqërisë është vetë ortaku z. Besnik Babasi, i biri i Bajramit, lindur më 29.03.1969, lindur në Tiranë, Shqipëri, nr. ID: G90327071J, adresa: Tiranë, Rruga "Donika Kastrioti", Njësia Administrative Nr.5, Nd.1, Hyrja 5, Ap.23, Kodi posatar 1019.

Neni 12

DISPOZITA TË FUNDIT

12.1 Shoqëria do të rregullohet, përveç këtij Akti Themelues edhe me norma të përcaktuara në Statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga Ortaku dhe si i tillë do të miratohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, ditën e legalizimit si person juridik në Shqipëri.

12.2 Ky Akt Themelimi është hartuar në 2(dy) kopje, në gjuhën shqipe, duke patur secila të njëjtën fuqi ligjore

Themeluesi

Besnik BABASI